



REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E BRENDSHME  
AGJENCIA E BLERJEVE TË PËRQENDRUARA

# KATALOG

**BLERJE ORENDISH DHE PAJISJESH PËR  
MOBILIM ZYRASH**



**2021**

Versioni 1.0

---

# PËRMBAJTJA

1. Fjalor i termave	Faqe 3
2. Hyrje	Faqe 4
3. Objekti	Faqe 5
4. Artikujt dhe specifikimet teknike	Faqe 6-90
5. Tabela e artikujve	Faqe 91-97

---

## 1. FJALORI I TERMAVE

OQB → Organi Qendror Blerës;

ABP → Agjencia e Blerjeve të Përqendruara;

**BLERJE ORENDISH DHE PAJISJESH PËR MOBILIM ZYRASH** → Në këtë kategori përfshihen: tavolina, karrige, skrivani, poltrona, varëse rrobash, etazherë, kasaforta, dollape, komodina, si dhe materiale të tjera që janë në funksion të mobilimit të zyrës.

---

## 2. HYRJE

Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës, në zbatim të Vendimit nr. 82, datë 14.02.2018 të Këshillit të Ministrave “Për ngarkimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrive dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra dhe shërbime”, i ndryshuar, prokuron fondet buxhetore, me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlera të vogla, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve në varësi të tyre, për blerjen e mallrave dhe të shërbimeve të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi.

Në pikën 1.4 të këtij vendimi është përcaktuar objekti “**Blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim zyrash**”, ku në këtë kategori do të përfshihen tavolina, karrige, skrivani, poltrona, varëse rrobash, etazherë, kasaforta, dollape, komodina, si dhe materiale të tjera që janë në funksion të mobilimit të zyrës.

Janar 2021

---

### **3. OBJEKTI**

Objekt i këtij katalogu është përcaktimi i specifikimeve teknike për materiale të nevojshme për autoritetet kontraktore, për artikuj si: tavolina, karrige, skrivani, poltrona, varëse rrobash, etazherë, kasaforta, dollape, komodina, si dhe materiale të tjera që janë në funksion të mobilimit të zyrës.

## 4. ARTIKUJT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

1. DOLLAP ME DY KANATA	
<b>Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi):</b>	90 x 45 x 210
<b>Karakteristikat kryesore të produktit:</b>	<p>Materiali i skeletit dhe kanatet do të jetë prej melaminë, me trashësi 1.6 deri 1.8 cm. Bordet anësore të skeletit, sergjeneve dhe kanateve do të jenë të veshura me PVC me trashësi jo më të vogël se 1 mm, e ngjashme me ngjyrën e melaminës. Kanatet do të montohen me mentesha metalike që lejojnë hapjen e lirë të kanateve. Sergjenet do jenë prej materiali melaminë me trashësi 2.5 cm. Materiali të ketë veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Xokula do të jetë 8 cm e lartë dhe prej të njëjtit material. të jenë të veshura (bordura) me material plastik PVC</p> <p>Kanatet të mbyllen me çelës. Pjesa e brendshme të ndahet në minimum 5 (pesë) hapësira me sergjene me mundësi regjistrimi sipas nevojës. Dorezat e kanateve dhe aksesoret e përdorur të jenë cilësorë.</p>
<b>Elementë të tjerë shtesë:</b>	Aksesorët e montimit do të jenë të fshehtë dhe të çmontueshëm në mënyrë të lehtë. Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.
<b>Standardi ku bazohet:</b>	Të plotësojë kërkesat e standardit DS CEN/TS 16209:2011 ose ekuivalentit të tij.
<b>Njësia e produktit:</b>	Copë

## 2. RAFT METALIK PËR ARKIVË

<b>Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi):</b>	100 x 42 x 250 cm
<b>Karakteristikat kryesore të produktit:</b>	Materiali i përdorur për këmbët do të jetë profil katror 30 x 30 x me spesor 1.6 deri 1.8 mm. Materiali i përdorur për vendosjen (sergjenat) e dosjeve do të jetë llamarinë e zezë me spesor 1.2 mm. Rafti do të ketë dhe një platformë melamine me shinë që do të shërbejë për një shikim të shpejtë të dosjes në vend.
<b>Elementë të tjerë shtesë:</b>	Ngjyra e raftit do të jetë gri metalizato. Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit.
<b>Njësia e produktit:</b>	Copë

## 3. SIRTARIERË E LËVIZSHME ME RROTA

<b>Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi):</b>	45 x 53 x 60 cm (lartësi së bashku me rrotat)
<b>Karakteristikat kryesore të produktit:</b>	Struktura e sirtarierës do të jetë melaminë me trashësi 1.6 deri 1.8 cm. Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Syprina dhe kapakët ballore të sirtarëve duhet të jenë prej material melamine me spesor. Bordet anësore, fiankeve të jenë të rrethuara me material plastik PVC. Sirtariera duhet të ketë 4 rrota sferike në fund dhe të mund të lëvizë nën tavolinë. Sirtari i parë nga lart duhet të jetë më i vogël dhe i përshtatur për të mbajtur sende të imëta, pjesa tjetër të ndahet në 3 sirtarë të barabartë. Sirtarët duhet të jenë të pajisur me kyç që të realizojë mbyllje qendrore. Aksesorët e përdorur duhet të jenë cilësorë, në mënyrë që të sigurojnë një qëndrueshmëri të lartë të sirtarierës.
<b>Elementë të tjerë shtesë:</b>	Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.
<b>Standardi ku bazohet:</b>	Të plotësojë kërkesat e standardit DS CEN/TS 16209:2011 ose ekuivalentit të tij dhe SSH EN 12529:1998 ose ekuivalentit të tij.
<b>Njësia e produktit:</b>	Copë

## 4. KARRIGE PËR SALLA KONFERENCASH

<b>Karakteristikat kryesore të produktit:</b>	Karriget të jenë dizenuar me një stil modern me skelet metalik prej tubash çeliku me profil oval 30 x15 mm dhe
---	--


	<p>spesor jo më të vogël se 1.3 mm dhe lyer me bojë elektrostatische. Shpinorja dhe ndenjësja në pjesën e brendshme kanë një kompesatë të kurbuar. Karriget kanë krahë në dy anët e saj dhe në krahun e djathtë vendoset një tavolinë e vogël, e lëvizshme, për të shkruar. Ndenjësja dhe shpinorja montohen në skeletin metalik me vida. Shpinorja dhe ndenjësja kanë mbushje gome sintetike me densitet të lartë. Tapiceria të jetë në stof të cilësisë së parë ose lëkure ekologjike.</p>
<b>Elementë të tjerë shtesë:</b>	<p>Karrigia të projektohet në mënyrë që të minimizojnë rrezikun e dëmtimit të përdoruesve. Të paketohen që të mos dëmtohen gjatë transportit. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.</p>
<b>Standardi ku bazohet:</b>	<p>Të plotësojë kërkesat e standardit SSH EN 1335-1:2000/AC:2002 ose ekuivalentit të tij.</p>
<b>Njësia e produktit:</b>	<p>Copë</p>







## 8. TAVOLINË PUNE + KOMODINË

<p><b>Përbëhet nga 2 pjesë kryesore:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Tavolinë pune (gjatësi x gjerësi x lartësi):</li> <li>- Komodinë me përmasa:</li> </ul>	<p>140 x 70 x 72 cm</p> <p>40 x 60 x h-68 cm</p>
<p><b>Karakteristikat kryesore të tavolinës së punës:</b></p>	<p>Syprina Melaminë me trashësi 2.5 cm. Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishjeve dhe njollave. Këmbët janë me planë të të njëjtit material dhe trashësi të syprinës. Bordet anësore të planit të punës dhe të këmbëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC. Bashkimi i planit të punës me këmbët bëhet në mënyrë të tillë që i jep tavolinës pamje solide. Pjesa ballore është e pozicionuar e tillë që realizon bashkimin e planit të punës me këmbët e tavolinës dhe qëndron në një hapësirë 40 cm, nga plani i dyshemesë. Aksesorët që përdoren për montimin e elementëve të tavolinës të jenë cilësorë. Në planin e punës të jetë e hapur një vrimë, në të cilën fiksohet një mekanizëm plastik në formë cilindri dhe bën të mundur kalimin e kabllave nga lart poshtë dhe anasjelltas. Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues.</p>
<p><b>Karakteristikat kryesore të komodinës:</b></p>	<p>Përbëhet nga 3 sirtarë me rrota lëvizëse, materiali të jetë i njëjtë me tavolinën.</p>
<p><b>Elementë të tjerë shtesë:</b></p>	<p>Montimi dhe çmontimi të jetë sa më i thjeshtë. Tavolina të projektohet në një mënyrë që të minimizohet rreziku i dëmtimit të përdoruesve. Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.</p>
<p><b>Standardi ku bazohet:</b></p>	<p>Të plotësojë kërkesat e standardeve:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- SSH EN 527-1:2011 ose ekuivalentit të tij.</li> <li>- SSH EN 527-2:2016 ose ekuivalentit të tij.</li> <li>- DS CEN/TS 16209:2011 ose ekuivalentit të tij.</li> </ul>
<p><b>Shembuj foto të produktit:</b></p>	 <p><b>Shënim: Modelet e shembujve janë udhërrëfyese.</b></p>
<p><b>Njësia e produktit:</b></p>	<p>Copë</p>